



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SU MARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agjencia za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Drejtorati Qendror i Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti

DATË/A:	19.01.2017
REFERENC-Ë:	DQIPGJ, 25/'2017
PËR/ZA/TO:	<b>Nehat Idrizi, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Rruga , Luan Hajredinaj,pa,nr-Prishtinë.</b>
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	<b>Ahmet ZEJNULLAHU,</b> Kryeshef Ekzekutiv i Agjencionit Pyjor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	<b>Besim ZOGU,</b> Drejtor i Drejtoratit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti, në APK-ës.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim.

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese dua të ju informoi lidhur me Vendimet e shumta që po vijnë në Drejtoratin Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti, Institucion cili është në kuadër të Agjencionit Pyjor të Kosovës-Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Vendime të tilla me Parashkrime të lëndëve na vijnë edhe nga Gjykatat tjera të Republikës së Kosovës por jo me një numër kaq të madh si nga Gjykata Themelore Prishtinë, Dega Podujevë-Divizioni i Kundërvajtjes të cilat janë për tu veçuar dhe për tu analizuar.

Për verifikimi e pretendimeve te mija ju ofroi dëshmitë se vetëm me datë,22.12.2016 në adresë të Drejtoratit Qendror të Insepkcionit për Pylltari dhe Gjueti nga kjo gjykatë: Gjykata Themelore Prishtinë,Dega Podujevë- Divizioni për kundërvajtje dhe nga Gjykatësi, z Xhevat Begolli kanë ardhur 24 lëndë të gjitha te parashkuara, të cilat do ju ofrojmë edhe si kopje fizike dhe përmbajnë këta numra të lëndëve:

K.nr.11253/14-3, K.nr.9275/14-3, K.nr.8584/13-3, K.nr.8582/13-3, K.nr.8583/13-3, K.nr.8286/13-3, K.nr.13252/13-3, K.nr.9931/12-3, K.nr.12122/12-3, K.nr.12121/12-3, K.nr.12120/12-3, K.nr.14768/12-3, K.nr.14767/12-3, K.nr.14766/12-3, K.nr.14765/12-3, K.nr.14764/12-3, K.nr.14763/12-3, K.nr.14762/12-3, K.nr.14760/12-3, K.nr.14761/12-3, K.nr.14769/12-3, K.nr.11254/14-3, K.nr.11255/14-3, K.nr.11254/14-3 dhe me datë, 17.01.2017 edhe lënda , K.nr.14707/13-3, pra ne total vetëm për muajin dhjetor, 2016 dhe gjysmën e muajit janar 2017, 25 lëndë të parashkuara nga po e njëjta Gjykatë dhe po i njëjti Gjykatës.

Qëllimi i këtij njoftimi nuk është ndërhyrja në punët e Gjykatës por të ju informoi për marrjen e masave në shtimin e efikasitetit dhe përgjegjesisë së punës se Gjykatave në përgjithësi dhe për rastin ne fjalë në veçanti, pasi ne si Institucion por edhe si shtet nga mos puna dhe jo efikasiteti i Gjykatave dëmtohem në shumë aspekte:

- Në aspektin e mos parandalimit të shkatërrimit te pyjeve dhe tokave pyjore pasi shkelësit e Ligjit mbesin te pa ndëshkuar.
- Dëmtohem edhe ne aspektin e humbjes se imazhit dhe autoritetit si Inspektorat por edhe si Polici pasi shumicën e aksioneve i organizojmë në koordinim dhe asistim, ndërsa masat tona mbesin pa efekte .
- Dëmtohem ne aspektin material pasi për identifikimin e një personi fizik apo juridik i cili dëmton pyjeve apo tokat pyjore përcillet me shpenzime logjistike por edhe me një shkallë te vështirësisë për legjitimim, sekuestrim te mjeteve te punës dhe masës drunore ilegale, ballafaqim me kërcënime verbale e jo rrallë, herë edhe sulme fizike.
- Institucioni ynë në veçanti por edhe Shteti në përgjithësi nga këto vendime dëmtohet financiarisht pasi sipas Ligjit për Pyje, Nr.03/L-153 për Plotësim Ndryshmin e Ligjit për Pyje 2003/3, Neni 36 paragrafi,36.3 për shumicën e veprimeve kundërvajtëse janë paraparë dënimet prej, 400-5.000/€ dhe vetëm nëse e marrim si shembull e 25 lëndë te ardhura brenda një muaj e gjysmë dhe sikur për këto lëndë të nxirren vendimet me dënimet minimale për shkelje e qe është, 400/€ i bie qe, kemi humbur , 10.00.00/€ pa u marr me efektet pozitive qe do kishin këto vendime me dënime edhe në parandalimin e përsëritjeve të veprave të njëjta, por nëse i shtojmë edhe realizmin e se drejtës se
- Institucionit për kërkimin e kompensimit, dëmet janë shumë më të mëdha.

Jemi te bindur se Këshilli Gjyqësor do e analizoj Njoftimin dhe do e merr shumë seriozisht shqetësimin ton për këtë dukuri, e cila nuk është tek te gjitha Gjykatat pasi kemi raste kur në disa Gjykata janë duke u shqyrtuar edhe lëndë të vitit 2016, ku ndoshta edhe është argument ynë dhe besimi se ndërmarrja e masave në shtimin e efikasitetit dhe përgjegjësisë së punës së Gjykatave në përgjithësi dhe te Gjykatës Themelore në Prishtinë Dega Podujevë- Divizioni për Kundervajtje në veçanti, do ndikon në pakësimin në mos jo eliminimin e tërësishëm të këtyre dukurive të parashkrimit të lëndëve . Gjithashtu ju njoftojmë se gjatë Inspektimeve në Komuna kemi vërejtur se dukuria e Parashkrimit të lëndëve të iniciuara nga Rojtarët e Pyjeve është një dukuri në rritje. Për të argumentuar shqetësimin e Institucionit tonë po ju sjelli edhe një shembull: Nga pasqyra vjetore e Aktvendimeve të Gjykatave të ardhura në Inspektorat gjatë vitit 2015 kemi pas, 59, Aktvendime me dënime, 66, Aktvendime kanë qen te pezulluar si pasoj e parashkrimit, kurse gjatë vitit, 2016, 45 - Aktvendime kanë qen me dënime, kurse 82, Aktvendime të pezulluar si pasoj parashkrimit të lëndëve, pra sipas këtij raporti jo qe nuk kemi zvogëlim por rritje enorme te numrit të lëndëve te Parashkruara. Në besojmë se me të tilla argumente, me një bashkëpunim të shtuar në mes Institucioneve duke i evidentuar te metat dhe parregullsitë, nuk ndërhyjmë në punën e Gjykatave por i ndihmojmë ato , pasi puna, përformanca dhe efikasiteti i jonë si Inspektorat po varet edhe nga puna, apo mos puna e Gjykatave .

Kësaj shkrese i bashkëngjisim 25 vendime e kësaj gjykate dhe të po te njëjtit Gjyqtar, z. Xhevat Begolli.

Me respekt!